

NJOFTIM PUNE

Profili i kompanisë: Balkan Finance Investment Group BALFIN Group, është një nga grupet investuese më të rëndësishme dhe më të suksesshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjeografikisht, Grupi BALFIN është i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni Veriore, Mali i Zi dhe Holandë, me afërsisht 6'000 punonjës në total. Aktivitetet e Grupit BALFIN përfshijnë zhvillimin dhe menaxhimin e pasurive të patundshme, shitjet me pakicë, industrinë minerare, sistemin bankar, turizmin, energjinë, logjistikën, etj. Grupi BALFIN po rritet në mënyrë të qëndrueshme dhe kontribuon në përmirësimin e jetesës së komuniteteve përmes zhvillimit ekonomik, prezantimit të ideve të reja, punësimit dhe investimeve sociale.

ACREM është pjesë e BALFIN Group e specializuar në ofrimin e menaxhimit të pasurive të paluajtshme. ACREM është kompania menaxhuuese e Qendrave tregtare TEG dhe QTU, si dhe TLP, Rolling Hills, dhe Ambassador 3. Me një rrjet profesionistësh ACREM, ofron një paketë të gjërë shërbimesh si: Konsulencë Financiare, Marketing, Qiradhënie dhe Administrim.

Pozicioni: Specialist/e Finance
Departmenti: Financë
Vendodhja: TEG/ ACREM

Përshkrim i Pozicionit të Punës

Specialisti/ja e Financës është personi përgjegjës që kryen regjistrimin dhe paraqet informacione me bazë financiare. Rakordon dhe mirëmban llogari financiare si dhe përgatit raporte financiare bazuar në kërkesat dhe politikat e grupit për këtë departament.

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Përgatit faturat e shitjes bazuar në kontratat e nënshkruara dhe bën shpërndarjen e tyre brenda afateve të përcaktuara.
2. Kryen regjistrimin e faturave të blerjes për Departamentin e Teknikës dhe shitjes dhe kujdeset në mirëmbajtjen dhe organizimin e llogarive të inventarit.
3. Kryen deklarin e Librit të Shitjes dhe të Blerjes në afatet e caktuara tatimore.
4. Regjistrimi ditor i transaksioneve bankare dhe atyre të arkës si dhe iniciimi i pagesave on-line.

5. Raporti javor mbi ditaret e arkës dhe bankës së bashku me dokumentacionin mbështetës dhe kujdesja që të mos mungojnë dokumentat e nevojshëm.
6. Përgatit raportet për arkëtimet për shërbimet e faturuara dhe çdo e drejtë e lindur ndaj palëve të treta.
7. Ndjek dhe kryen rakordime periodike me klientë/furnitorë dhe palët e lidhura në lidhje me detyrimet dhe të drejtat e lindura.
8. Kryen inventarizimin fizik të aseteve dhe materialeve të mirëmbajtjes sipas procedurave të Shoqërisë.
9. Kryen detyra të tjera të ngarkuara sipas nevojave të departamentit të caktuara nga Menaxheri i Financës.

Kërkesat e pozicionit të punës:

- Jo më pak se 3 vite në të njëjtin profil pune.
- Diplomë Bachelor dhe/ose Diplomë Master në Financë-Kontabilitet dhe/ose Administrim Biznesi.
- Të njohë dhe të përdorë programet NAVISION/ FINANCA 5.
- Aftësi të shkëlqyera të punës në grup.
- Njohje të shkëlqyera të gjuhës angleze (preferohet njohje e gjuhëve të tjera të huaja)
- Njohuri të shkëlqyera kompjuterike.

Other Skills/Abilities

- Aftësi të mira komunikuese dhe prezantuese.
- Aftësi për të analizuar dhe interpretuar të dheëna financiare.
- Metodik/e dhe i/e organizuar.
- Ndershmëri dhe Intergitet

Kushtet e Punës: BALFIN Group ofron një paketë tërheqëse përfitimesh, duke përfshirë një shpërblim të drejtë në vlerësimin e meritës dhe performances.

Mënyra e aplikimit*:

Për të aplikuar për këtë pozicion, ju lutem dorëzoni CV-në dhe Letrën e Motivimit brenda datës **24/04/2022** në adresën e e-mail: hr@acrem.al

**Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr 9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për “Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.*